

Vendim nr. 93 datë 03.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 03.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (R) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **RESHAT GEGA**, përfaqësuar nga avokat Tauland Asllanaj, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 560/347, datë 05.06.2015 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2023-4683, datë 15.11.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 31, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 399/1 e vijues, 472/a, 475 dhe 485/b të Kodit të Procedurës Civile (KPC); nenet 296, 298 etj. të Kodit Civil (KC); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se me kontratat e shitblerjes së datës 01.12.2010 kërkuesi Reshat Gega ka blerë nga shtetasi A.Sh. dhe bashkëshortja e tij një apartament me sipërfaqe 105 m² dhe pasurinë bodrum me sipërfaqe 75 m², të ngritur mbi truall, me sipërfaqe 53 m² në qytetin e Gjirokastrës. Shtetasi A.Sh. e ka përfitur këtë pasuri nëpërmjet privatizimit të godinës së repartit ushtarak 5500, Gjirokastrë. Në kontratën e marrjes në dorëzim të apartamentit, përveç të dhënave të pasurisë, parashikohet se në kushtet e një banese me shumë apartamente, secili pronar apartamenti gëzon të drejtën e pronësisë për apartamentin e tij (prona individuale) dhe një pjesë të pronës së përbashkët (kafazi i shkallëve, tarraca, themelet etj.) që është në funksion të raportit të sipërfaqes së apartamentit individual. Në planimetrinë e pasurisë pasqyrohet sipërfaqja e apartamentit dhe një kafaz shkallësh që lidh katin e parë të godinës me katin e dytë.

2. Shtetasi S.K. ka blerë nga Enti Kombëtar i Banesave me kontratën e datës 25.03.2011 pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 78 m², e cila kufizohet poshtë me apartamentin e kërkuesit dhe ka një aks të përbashkët me të. Midis kërkuesit dhe shtetasit S. K. ka lindur një mosmarrëveshje, për sa i përket kafazit të shkallëve që lidh katin e parë të godinës me katin e dytë dhe që gjen pasqyrim në planimetrinë e apartamentit, e cila ishte shndërruar në dhomë banimi. Shtetasi S. K. ka kryer punime duke zgjeruar portën hyrëse dhe përvetësuar dhomën e krijuar më parë nga A.Sh.

3. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt pushimi i cenimit në pronësi, rivendikimi (lirimi dhe dorëzimi) i dhomës që përkon me sheshpushimin e katit të dytë dhe shpërblimi i dëmeve të shkaktuara nga i padituri S.K. me punimet e kryera në këtë ambient.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 21-2013-841/430, datë 08.05.2013, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë; detyrimin e të paditurit S.K. me shpenzimet e tij të prishë soletën e ndërtuar në hapësirën e shkallëve, të rihapë dritaren e mbyllur duke e kthyer strukturën ekzistuese në gjendjen e mëparshme. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim i padituri S.K. dhe kërkuesi.

5. Me vendimin nr. 928/285, datë 09.06.2014, Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka vendosur prishjen e vendimit civil nr. 21-2013-841/430, datë 08.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

6. Në rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 21-2014-487, datë 10.11.2014, ka vendosur pranimin e pjeshëm të kërkesëpadsisë; detyrimin e të paditurit S.K. të ndalojë cenimin e pronës; kthimin në gjendjen e mëparshme si në momentin e privatizimit; lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes së krijuar nga i padituri S.K. me sipërfaqe 24 m²; detyrimin e shpërblimit të dëmit të shkaktuar nga punimet për kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme në vlerën 27.420 lekë.

7. Mbi ankimin e të paditurit në gjykim, S.K., Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. 560/347, datë 05.06.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 21-2014-487, datë 10.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe rrëzimin e padsisë si të pabazuar në ligj e në prova. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkuesi dhe kundërrekurs shtetasi S.K. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4683, datë 15.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ishte bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të KPC-së.

8. Në datën 15.03.2024 (*sipas shënimit të shërbimit postar*) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuetit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar:

9.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi, së pari*, Gjykata e Lartë ka anashkaluar prova të rëndësishme shkresore, si aktet e fitimit të pronësisë dhe aktet e ekspertimit të realizuara në gjykatat e faktit. Gjykata e Lartë e ka konsideruar të ligjshëm vendimin e gjykatës së apelit, ndonëse provat nuk janë shqyrtuar në mënyrë të mjaftueshme nga kjo gjykatë. *Së dyti*, Gjykata e Lartë ka legjitimuar shkeljen e ligjit

- të bërë nga gjykata e apelit, e cila ka lejuar marrjen, administrimin dhe shqyrtimin e aktit të ekspertimit të ekspertes I.L., i cili është provuar se përmban të dhëna të rreme. Në këtë drejtim nuk është trajtuar vendimi i prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal, i cili është shprehur se përfundimet e aktit të ekspertimit kanë qenë të gabuara dhe në kundërshtim me të vërtetën. *Së treti*, Gjykata e Lartë nuk ka bërë një analizë se përse vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar dhe ai i gjykatës së apelit është i drejtë, ose të ketë kontrolluar nëse kjo e fundit ka zbatuar drejt ligjin, për sa i përket mosmarrjes në konsideratë të akteve të ekspertimit.
- 9.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjykata e apelit ka mbajtur qëndrim të njëanshëm për sa i përket vlerës së provave, duke zhvlerësuar provat në favor të kërkuarit. Ajo ka përfshirë në proces prova të parregullta që mbështesnin pretendimet e palës së paditur në proces, konkretisht aktin e ekspertes I.L., duke ia vënë në dispozicion ekspertëve të caktuar prej saj. Gjithashtu, ajo gjykatë është shprehur se planimetria bashkëlidhur kontratës së privatizimit të banesës nuk është akt i mbajtur në formën e kërkuar nga ligji, ndonëse është hartuar nga specialistë të fushës dhe nënshkruar rregullisht nga anëtarët e komisionit përkatës. Në këtë mënyrë gjykata e apelit ka paracaktuar vlerën e provave, duke hedhur dyshime serioze për paanshmërinë e saj. Edhe Gjykata e Lartë nuk i ka analizuar këto shkelje të gjykatës së apelit.
- 9.1.3. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë bërë pjesë të analizës dhe arsyetimit aktet e ekspertimit. Gjithashtu, përfshirja dhe bërja pjesë e provave të aktit të ekspertes I.L. përbën shkelje të rëndë procedurale. Për këtë shkak kërkuari është vendosur në pozita të pabarabarta dhe të disfavorshme me palën tjetër.
- 9.1.4. *Parimit të sigurisë juridike, të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi kërkuari është bërë pronar i pasurisë objekt gjykimi përmes një kontrate të rregullt noteriale dhe ka ushtruar të drejtën e pronësisë për një periudhë të gjatë i pashqetësuar.
- 9.1.5. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 23.10.2015, ndërsa vendimi i kësaj gjykate është dhënë në datën 15.11.2023, pra 8 vjet më vonë.

- 9.1.6. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit të kërkuarit se gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh aktet e ekspertimit. Kjo e fundit kishte detyrimin ta arsyetonte qëndrimin e saj bazuar në nenin 224/b/2 të KPC-së. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit tjetër se gjykata e apelit kishte lejuar administrimin dhe më pas heqjen nga dosja të provave të kundërligjshme, sikurse është akti i ekspertës I.L. Ndonëse dy vendimet e gjykatave më të ulëta janë diametralisht të kundërta, Gjykata e Lartë është mjaftuar me argumentin se pretendimet e kërkuarit nuk gjejnë mbështetje në ligj. Vendimi i gjykatës së apelit është i paargumentuar, i pambështetur në prova, i paqartë dhe i pambështetur në ligj.
- 9.2. *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi kërkuari është bërë pronar përmes një kontrate të rregullt noteriale, pronë të cilën e ka poseduar në mënyrë të qetë deri në vitin 2012. Gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë e kanë zhveshur kërkuarin nga pronësia për të favorizuar palën e paditur, duke zhvilluar një proces të parregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë

kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 23, datë 10.10.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së drejtës për t’u gjykuar brenda afatit të arsyeshëm, pasi çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 23.10.2015, ndërsa vendimi i kësaj gjykate është dhënë në datën 15.11.2023, pra 8 vjet më vonë. Në lidhje me këtë pretendim, nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën, nuk rezulton që kërkuesi t’i jetë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Referuar përmbajtjes së ankimit kushtetues, Kolegji vëren se ai nuk ka parashtruar asnjë argument se këto mjete nuk janë efektive për mbrojtjen e së drejtës së tij për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, si një aspekt i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se ai nuk legjitimohet për sa i përket këtij pretendimi, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive.

14. Gjithashtu, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit ka lejuar marrjen, administrimin dhe shqyrtimin e aktit të ekspertimit të ekspertes I.L., i cili është provuar

se përmban të dhëna të rreme. Për këtë pretendim kërkuesi ka argumentuar se i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si dhe e ka ngritur atë si argument shtesë në drejtim të pretendimeve për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve dhe standardit të arsytimit të vendimit. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton se kërkuesi nuk e ka ngritur në rekursin e tij drejtuar Gjykatës së Lartë, duke mos shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

15. Për sa u përket pretendimeve të tjera, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë e substancë dhe pas përfundimit të procesit gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit të zakonshëm, për rrjedhojë ai ka shteruar mjetet juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.

16. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 15.11.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 15.03.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae* kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregull ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve, parimit të sigurisë juridike, të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme, standardit të arsytimit të vendimit dhe së drejtës së pronës.

18. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuesit lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, Kolegji vlerëson ta analizojë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

19. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimit të barazisë së armëve me argumentin se gjykatat nuk kanë bërë pjesë të arsytimit aktet e ekspertimit, por kanë përfshirë një akt ekspertimi i cili është i falsifikuar. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e parimit të parimit të sigurisë juridike, të drejtave të fituara dhe pritshmërive të ligjshme, pasi ai është bërë pronar përmes një kontrate noteriale dhe ka ushtruar të drejtën e pronës për një periudhë të gjatë i pashqetësuar. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit interpretimi i

ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, çmuarja e provave, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, si dhe të çmuarjes së provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 45, datë 23.07.2012; nr.31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në referim të standardeve të mësipërme, Kolegji çmon se bazuar në përmbajtjen dhe thelbin e këtyre pretendimeve, ato janë më tepër të natyrës ligjore dhe kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe zbatimit të ligjit, të cilat, si rregull, janë atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues, për rrjedhojë kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*.

21. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë ka anashkaluar prova të rëndësishme shkresore, si aktet e fitimit të pronësisë dhe aktet e ekspertimit të realizuara në gjykatat e faktit dhe ka konsideruar të ligjshëm vendimin e asaj gjykate ndonëse provat nuk janë shqyrtuar në mënyrë të mjaftueshme prej saj, si dhe nuk ka bërë një analizë se përse vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar dhe ai i gjykatës së apelit është i drejtë, ose të ketë kontrolluar nëse kjo e fundit ka zbatuar drejt ligjin për sa i përket mosmarrjes në konsideratë të akteve të ekspertimit. Nisur nga thelbi i këtij pretendimi të kërkuesit, ai do të analizohet në vijim në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit, i cili *prima facie* hyn në juridiksionin e Gjykatës.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit

22. Në këndvështrim të këtij standardi, kërkuesi ka ngritur pretendime për procesin gjyqësor në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë. Sipas tij, kjo e fundit ka anashkaluar prova të rëndësishme shkresore, si, aktet e fitimit të pronësisë dhe ato të ekspertimit të realizuara në gjykatat e faktit dhe e ka konsideruar të ligjshëm vendimin e asaj gjykate, ndonëse provat nuk janë shqyrtuar në mënyrë të mjaftueshme prej saj, si dhe Gjykata e Lartë nuk ka bërë një analizë se përse vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar dhe ai i gjykatës së apelit është i drejtë,

ose të ketë kontrolluar nëse kjo e fundit ka zbatuar drejt ligjin për sa i përket mosmarrjes në konsideratë të akteve të ekspertimit. Gjithashtu, sipas kërkesit, Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit se gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh aktet e ekspertimit. Kjo e fundit kishte detyrimin ta arsyetonte qëndrimin e saj bazuar në nenin 224/b/2 të KPC-së. Ndonëse dy vendimet e gjykatave më të ulëta janë diametralisht të kundërta, Gjykata e Lartë është mjaftuar me argumentin se pretendimet e kërkesit nuk gjejnë mbështetje në ligj. Vendimi i gjykatës së apelit është i paargumentuar, i pambështetur në prova, i paqartë dhe i pambështetur në ligj.

23. Gjykata ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Lidhur me vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për proces të rregullt ligjor. Kjo sepse, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 27, datë 27.03.2017; nr. 18, datë 14.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt pushimi i cenimit në pronësi, rivendikimi (lirimi dhe dorëzimi) i dhomës që përkon me sheshpushimin e katit të dytë dhe shpërblimi i dëmeve të shkaktuara nga i padituri S.K. me punimet e kryera në këtë ambient. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur pranimin

e padisë, duke arsyetuar se kërkuesi është pronar i ambienteve të blera dhe të regjistruara në Zyrën Vendore të Pasurive të Paluajtshme, Gjirokastrë, (ZVRPP, Gjirokastrë) dhe bashkëpronar në elemente të përbashkëta me të paditurin në gjykim, i cili ka kryer punime të ndryshme në hapësirën e shkallëve pa lejen e tij, duke cenuar gëzimin e qetë të pronës.

26. Në këtë kundërt të këtij qëndrimi, gjykata e apelit ka çmuar se gjykata e shkallës së parë është marrë me analizën e gjendjes së faktit sipas përfundimeve të ekspertes dhe nuk ka bërë analizë ligjore të çështjes. Në këtë këndvështrim, gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim aktet pranë ZVRPP-së, Gjirokastrë, duke konstatuar se rezultojnë dy praktika me të njëjtin numër reference, njëra për pasurinë apartament dhe tjetra për pasurinë bodrum, ku vetëm për të parën konstatohet planvendosje. Sipas kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë nuk ka interpretuar drejt kontratën e privatizimit, e cila kafazin e shkallëve e përfshin në rrethin e sendeve në bashkëpronësi të detyrueshme. Ndonëse planimetria e apartamentit është 105 m², vërtetësia e këtij akti nuk është bërë e mundur, pasi mungojnë regjistrime të mëparshme hipotekare. Gjithashtu, nga akti i ekspertimit gjykata krijon bindjen se hyrja në apartament e shtetasit S.K. vështirësohet nëse kafazi i shkallëve i kthehet kërkuesit. Pra, me kontratën e privatizimit nuk janë fituar të drejta pronësie, por të bashkëpronësisë së detyrueshme për kafazin e shkallëve, për rrjedhojë, sipas kësaj gjykate, kërkuesi nuk arrin të provojë të drejtën e pronësisë për sendin në konflikt.

27. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar me rekurs Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe në kundërshtim me provat të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe i padituri në gjykim i ka cenuar pronën, duke e zhveshur nga posedimi. Gjithashtu, sipas tij, gjykata e apelit ka arsyetuar në kundërshtim me aktet e ekspertimit.

28. Gjukata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se pjesa e pretendimeve në rekurs, që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, si dhe nëpërmjet rekursit dhe gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk mund të pretendohet të rihapet edhe një herë shqyrtimi gjyqësor i provave. Ushtrimi i kontrollit rishikues të Gjykatës së Lartë nuk mund të konsistojë në një rivlerësim të provave në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e faktit, për shkak se një rivlerësim i tillë bie ndesh me vetë natyrën e gjykimit në këtë Gjykatë. Gjithashtu, gjykatat më të ulëta e kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë dhe vendimet e tyre nuk bien në kundërshtim

me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafët 28 dhe 29 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

29. Kërkuesi gjithashtu ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje pretendimit se gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh aktet e ekspertimit, veçanërisht në kushtet e dy vendimeve diametralisht të kundërta. Lidhur me këtë, Kolegji thekson se Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj si gjykatë e ligjit, ndërkohë që vetëm fakti se ajo ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomën e këshillimit, nuk është i mjaftueshëm në nivel kushtetues për të vënë në dyshim vendimmarrjen e saj. Në këtë pikëpamje, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesit në rekurs janë me natyrë ligjore, pasi kanë të bëjnë me fuqinë provuese të provave në përcaktimin e fakteve të mosmarrëveshjes, si dhe me interpretimin e ligjit procedural për fuqinë dhe vlerën e provave, si dhe zbatimin e keq të ligjit material. Për këtë shkak, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, nuk rezulton të jetë alogjik dhe të ketë kundërthënie, ndërsa pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv, duke plotësuar kështu kërkesat për respektimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Ai pasqyron në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit dhe vlerësimin e kolegjit në vështrim të nenit 472 të KPC-së për natyrën e këtyre shkaqeve. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, për sa kohë pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt janë haptazi të pabazuara, edhe pretendimi i tij për cenimin e së drejtës së pronës është po kështu haptazi i pabazuar.

31. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.
Tiranë, më 03.05.2024